



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 mars 2013  
Nr. ref.:VTK401/13

## VENDIM PËR HEQJEN E KËRKESËS NGA LISTA

në

**Rastin Nr. KI37/12**

Parashtrues

**Murtez Gashi dhe Shehide Gashi**

**Kontestim i kushtetutshmërisë së vendimit të Këshillit Gjyqësor të  
Kosovës, të 29 nëntorit 2011**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe  
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues të kërkesës janë Murtez dhe Shehide Gashi, nga Fushë-Kosova, të përfaqësuar nga Bahtir Troshupa, për Qendrën Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë.

## **Objekti i çështjes**

2. Parashtruesit pohojnë se nuk u është siguruar e drejta për barna falas, të përfshira në listën falas sipas Ligjit për Shëndetësi, dhe kjo përbën diskriminim, pasi ata janë anëtarë të një komuniteti të rrezikuar dhe të një grupi të marginalizuar, d.m.th. të komunitetit ashkali.
3. Për më tepër, parashtruesit pohojnë se Strategjia Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra nuk është në përputhshmëri me politikën e prioriteteve dhe me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjë që përbën shkelje të nenit 53 të Kushtetutës dhe, si e tillë, duhet të shpallet jokushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës; nenin 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 32 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Përmbledhje e fakteve, bazuar në dokumentet e paraqitura nga parashtruesit**

5. Më 16 shtator 2009, parashtruesit dorëzuan kërkesë me shkrim në Departamentin Komunal të Shëndetësisë në Fushë-Kosovë. Në kërkesën në fjalë, autoriteteve lokale u janë bërë me dije të drejtat e parashtruesve sipas nenit 22.1 të Ligjit për Shëndetësi, që ka të bëjë me barnat esenciale të përfshira në listën falas, si dhe përgjegjësinë e Republikës së Kosovës për t'u siguruar komuniteteve të cënueshme dhe grupeve të marginalizuara qasje të barabartë në shërbime shëndetësore pa diskriminim, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve.
6. Më 4 nëntor 2009, kërkesa e parashtruesve është vënë në vëmendje të Njesisë për të Drejtat e Njeriut të Ministrisë së Shëndetësisë. Udhëheqësi i Njesisë, përgjegjës për monitorimin e rasteve diskriminuese në sektorin shëndetësor, nuk ka ndërmarrë ndonjë hetim për të konfirmuar ndonjë diskriminim potencial, siç kishte premtuar fillimisht.
7. Më 12 mars 2010, parashtruesit parashtruan padi kundër Qeverisë së Kosovës, e evidencuar si Rasti nr. 565/2010.
8. Më 29 korrik 2011, parashtruesit i shkruan Kryetarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, duke kërkuar që t'i japë prioritet rastit të tyre. Ata nuk morën ndonjë përgjigje.
9. Më 28 tetor 2011, parashtruesit i shkruan Kryetarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke kërkuar që t'i japë prioritet rastit të tyre, sepse vonesa në shqyrtimin e rastit do të ishte e dëmshme për shëndetin e parashtruesve.
10. Më 29 nëntor 2011, parashtruesit pranuan një përgjigje nga Departamenti Ligjor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me ç'rast u informuan se lënda për të cilën kishin

ngritur padi nuk hynte në kategorinë e rasteve me prioritet në bazë të Strategjisë Shtetërore për Reduktimin e Lëndëve të Vjetra.

### **Procedura në Gjykatë**

11. Më 29 mars 2012, nëpërmjet Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë, parashtruesit dorëzuan kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.
12. Më 20 prill 2012, Gjykata kërkoi sqarim përkitazi me autorizimin e Qendrës Evropiane për Çështje të Minoriteteve, Kosovë, për ta parashtruar kërkesën në emër të parashtruesve.
13. Përfaqësuesi i parashtruesve u përgjigj, duke theksuar se, për shkak të sëmundjes së njërit prej parashtruesve, ata nuk ishin në gjendje ta siguronin autorizimin në atë kohë.
14. Më 22 maj 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Gjyljeta Mushkolaj.
15. Më 25 maj 2012, përfaqësuesi i parashtruesve e njoftoi Gjykatën se ishin paraqitur rrethana të reja, të cilat tregonin se parashtruesit nuk ishin në gjendje të vazhdonin tutje me kërkesën.
16. Më 2 korrik 2012, Kryetari, me Vendimin (Nr. K.SH. KI37/12) caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović anëtar të Kolegjit shqyrtues, pasi mandati i gjyqtares Gjyljeta Mushkolaj, si gjyqtare e Gjykatës, kishte përfunduar.

### **Vlerësimi i Gjykatës**

17. Për të vendosur se çfarë hapash të tjerë duhet ndërmarrë pas komunikimit me përfaqësuesin e parashtruesve, Gjykata i referohet rregullit 32 të Rregullores së punës të Gjykatës.
18. Rregulli 32, i Rregullores së punës përcakton:

#### *“Rregulli 32*

#### *Tërheqja e kërkesës dhe e përgjigjes*

- (1) *Pala mund të tërheqë kërkesën, ose përgjigjen e parashtruar për atë kërkesë, në çdo kohë para fillimit të seancës dëgjimore, ose në çdo kohë para marrjes së vendimit nga Gjykata, nëse vendimi merret pa seancë dëgjimore.*
- (2) *Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të përcaktojë të vendosë në lidhje me të.*
- (3) *Në rast të tillë, Gjykata vendos pa seancë dëgjimore, duke u bazuar vetëm në kërkesë, në përgjigjet e parashtruara dhe në çfarëdo dokumentesh të bashkëngjitura asaj.*

- (4) Gjykata mund të hedhë poshtë një kërkesë, kur përcakton se pretendimet në të janë të diskutueshme, ose që nuk përfaqësojnë një rast ose kontest.
- (5) Sekretariati njofton të gjitha palët me shkrim për çfarëdo tërheqje, për çfarëdo vendimi të Gjykatës për të vendosur në lidhje me kërkesën, pavarësisht tërheqjes së saj, dhe për çfarëdo vendimi për ta hedhur poshtë kërkesën para vendimit përfundimtar.”

19. Më 19 shtator 2012, duke marrë parasysh zhvillimet e sipërpërmendura, Gjyqtarja raportuese, Snezhana Botusharova, i rekomandoi Kolegjit shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Robert Carolan (kryesues), Altay Suroy dhe Ivan Čukalović, që të ndërpresë shqyrtimin e mëtejshëm të kërkesës. Pasi dëgjoi propozimin e Gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues u pajtua se nuk ekzistojnë rrethana të posaçme përkitazi me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të parashtruesve, të cilat do të kërkonin shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës dhe, po të njëjtën datë, ia përcolli rekomandimin e vet Gjykatës.


### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 20 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 32 të Rregullores së punës, njëzëri:

### **VENDOSI**

- I. TA HEQË kërkesën nga lista;
- II. Ky vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Gjyqtarja raportuese**



Snezhana Botusharova



**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. dr. Enver Hasani